REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorëzuar / Primljeno/Prodato / Recieved/Delivery 03 . 12 . 2018 viti god year

Organ./Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr.Prot: Br.Prot: Prot.No:	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHK	7345/2018		1/4

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.671/2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Hajzer Salihu dhe Shkëmb Manaj-anëtarë dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesionale, kanë shqyrtuar kërkesën e datës 18.10.2018 me numër protokolli 6161/2018 të parashtruar nga ankuesi Radosh Iliç nga Komuna e Leposaviqit me të cilin ka kërkuar shqyrtimin e ankesa me numër A.nr.416/2018 të datës 09.07.2018, kundër organit të punësimit Komuna e Leposaviqit, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 03.12.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.671/2018 e datës 18.10.2018, e parashtruar nga ankuesi Radosh Iliç.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 360/1 i datës 17.09.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Leposaviqit.

A r s y e t i m

Ankuesi Radosh Ilic, i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 28.02.2012 dhe të datës 01.07.2016 në pozitën "Udhëheqës i Ekipit për Ndihmë Sociale" në Komunën e Leposaviqit, nga muaji prill 2018 nuk i është proceduar paga në xhirollogarinë e tij për punën e tij pa ndonjë vendim të institucionit apo arsye. Më datë 17.05.2018 i është drejtuar Drejtorisë së Financave me kërkesë mirëpo nuk ka marr përgjigje dhe pas kësaj më datë 04.06.2018 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Leposaviqit. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Leposaviqit edhe për kundër obligimit ligjor të paraparë më dispozitat ligjore në fuqi nuk ka shqyrtuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi, kundër heshtjes administrative të Komunës së Leposaviqit, më datë 09.07.2018, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3833/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, me datë 03.09.2018 ka marrë vendimin me numër A.nr.416/2018 me të cilin vendim ka detyruar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Leposaviqit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit, të bëjë shqyrtimin e ankesës së datës 04.06.2018 të parashtruar nga ankuesi Radosh Iliç.

Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Leposaviqit, duke e bërë zbatimin e vendimit me A.nr.416/2018 të datës 03.09.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 17.09.2018 merr vendimin me numër 360/1 me të cilin vendim është refuzuar ankesa e ankuesit Radosh Iliç si e pa bazuar.

Ankuesi Radosh Iliç, me datë 18.10.2018 ka parashtruar kërkesën me numër të protokollit 6161/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me të cilën e ka njoftuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës se nuk është zbatuar vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe ka kërkuar nga Këshilli që të ndërmerren masat në pajtim me Ligjin, që këto konteste të zgjidhen ne afat sa më të shkurtë, ndërsa Këshilli në bazë të kërkesës së ankuesit Radosh Iliç ka aktivizuar lëndën me numër A.nr.416/2018 të datës 09.07.2018.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: E-mail i datës 27.11.2018; Konkursi i datës 02.06.2017; Vendimi i datës 03.07.2017; Kandidatët e pranuar sipas konkursit të ri në Korrik të vitit 2017; Lista për pagesën e pagave në Qendrën për Punë Sociale të datës 14 tetor 2017; Lista për pagesën e pagave në Qendrën për Punë Sociale të datës 14 tetor 2018; E-mail i datës 30.11.2018; Dërgimi i të dhënave lidhur me shkresën e juaj të datës 29.11.2018 nga Komuna e Leposaviqit me numër SI datë 29.11.2018; Lista e pagave prill 2018 nga Republika e Serbisë; Lista e pagave gushtë 2018 nga Republika e Serbisë; Lista e pagave shkurt 2018 nga Republika e Serbisë; Lista e pagave janar 2018 nga Republika e Serbisë; Lista e pagave qershor 2018 nga Republika e Serbisë; Lista e pagave maj 2018 nga Republika e Serbisë; Lista e pagave mars2018 nga Republika e Serbisë; Lista e pagave nëntor 2018 nga Republika e Serbisë; Lista e pagave shtator 2018 nga Republika e Serbisë; Lista e pagave korrik 2018 nga Republika e Serbisë; Lista e pagave tetor 2018 nga Republika e Serbisë; Kërkesa e ankuesit Radosh Iliç e datës 18.10.2018 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në kërkesë e datës 18.10.2018 nga Komuna e Leposaviqit; Aktvendimi i datës 17.09.2018 me numër 360/1 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Leposaviqit; Vendimi me numër 15/52 i datës 22.06.2018 i Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Ankesa e ankuesit e datës 09.07.2018 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Letër njoftimi i ankuesit Radosh Iliç; Certifikata e ankuesit Radosh Iliç e datës 10.02.2005; Kërkesa e ankuesit e datës 17.05.2018 e parashtruar për Drejtorinë e Financave në Komunën e Leposaviqit; Ankesa e ankuesit e datës 04.06.2018 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Leposaviqit; Marrëveshje mirëkuptimi në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunës së Leposaviqit e datës 03.06.2016; Lista e punëtorëve të Qendrës për Punë Sociale e datës 25.05.2016; Akt emërimi i ankuesit Radosh Iliç i datës 01.07.2016 me numër 01; Akt emërimi i ankuesit Radosh Iliç i datës 28.02.2012 me numër 321; Kontrata e marrëdhënies së punës e ankuesit Radosh Iliç e datës 21.04.2010 me numër 902; Kontrata e marrëdhënies së punës e ankuesit Radosh Iliç e datës 29.03.2007 me numër 2060; Kontrata e marrëdhënies së punës e ankuesit Radosh Iliç e datës 01.04.2002; Xhirollogaria e ankuesit Radosh Iliç; Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër A.nr.416/2018 i datës 03.09.2018; Kërkesa për largimin nga lista e pagave e datës 17.01.2018 nga Kryetari i Komunës së Leposaviqit për MAPL; Kërkesë për dhënien e pëlqimit për largimin nga lista e pagave e datës 11.06.2018 nga Kryetari i Komunës së Leposaviqit; Kërkesa për largimin nga lista e pagave e datës 16.08.2018 nga Kryetari i Komunës së Leposaviqit; Kërkesë për largimin nga lista e pagave e datës 15.08.2018 nga Kryetari i Komunës së Leposaviqit; Vendimi i datës 03.08.2018 me numër 710 i Kryetarit të Komunës së Leposaviqit; Raporti i Komisionit i datës 10.07.2018; Tabela e punëtorëve të cilët fshihen nga lista e pagave për shkak të anulimit të konkursit në bazë të cilit janë pranuar në marrëdhënie pune; Aktvendimi për formimin e Komisionit për rishqyrtimin e ligjshmërisë së konkursit të shpallur me datë 02.06.2017; Kërkesë për respektimin e procedurave për shpalljen e konkursit në

Komunën e Leposaviqit të datës 08.12.2016 nga Ministri i MAPL; Njoftim i datës 15.09.2015 si dhe kërkesa për pranimin e punëtorëve e datës 19.07.2017.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit Radosh Iliç, ***është e pabazuar, sepse:***

Ankuesi Radosh Iliç, në bazë të aktvendimit të datës 21.09.1990 të lëshuar nga Qendra për Punë Sociale nga Komuna e Leposaviqit, ka themeluar marrëdhënien e punës në Komunën e Leposaviqit ndërsa në bazë të marrëveshjes së mirëkuptimit të lidhur ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të Republikës së Kosovës dhe të Komunës së Leposaviqit me datë 03.06.2016, me të cilën është bërë bartja e kompetencave për çështje sociale në nivel komunal, mbi këtë bazë ankuesi Radosh Iliç ka akt emërimin e datës 01.07.2016 me numër 01/2016 në vendin e punës "Udhëheqës i Ekit për Ndihmë Sociale".

Ankuesi Radosh Iliç, fillimisht deri në muajin mars 2018 është paguar nga buxheti i Republikës së Kosovës respektivisht nga Komuna e Leposaviqit, mirëpo nga muaji mars ankuesi është larguar nga lista e pagave me arsyetimin që i njëjti paguhet edhe nga buxheti i Republikës së Serbisë. Mbi këtë bazë Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar provat e lëndës dhe ka konstatuar se Kryetra i Komunës së Leposaviqit me datë 17.01.2018 ka parashtruar kërkesën me numër 400-76 për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për largimin nga lista e pagave, pastaj duke u ndërlidhur me këtë Kolegji, ka shqyrtuar listat e pagave të dërguara nga Komuna e Leposaviqit për ankuesin Radosh Iliç i cili ka marrë pagën dhe vazhdon të marrë pagën nga buxheti i Republikës së Serbisë, rrjedhimisht nënkuptohet se ankuesi Radosh Iliç në të njëjtën kohë ka realizuar dy paga nga dy shtete të ndryshme që është në kundërshtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë dhe të Marrëveshjes së Brukselit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka pas parasysh edhe Vendimin me Nr. 15/52 të datës 22.06.2018 të lëshuar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës, me të cilin Vendim është aprovuar kërkesa e datës 11.06.2018 me numër 410/2018 e parashtruar nga Kryetari i Komunës së Leposaviqit për largimin e nëpunësve nga lista e pagave, të cilët kanë qenë në listën e pagave dhe të cilët janë financuar nga buxheti i veçantë i Qeverisë, para nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit të vitit 2013 dhe po ashtu është obliguar Ministria e Financave që në bashkëpunim me Komunën e Leposaviqit që t`i ndërmarrin veprimet sipas legjislacionit në fuqi, lidhur me largimin e punëtorëve që figurojnë me vlerë zero në listën e pagave.

Bazuar në dispozitat ligjore të nenit 44 të Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës është përcaktuar se ***"Puna e nëpunësit civil kompensohet përmes sistemit të pagave, i cili rregullohet me ligj të veçantë",*** me dispozitat e nenit 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Paga e Nëpunësve Civil është përcaktuar se: ***"Mjetet financiare për pagat, shtesat dhe kompensimet e tjera të nëpunësve civilë, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës",*** neni 3 paragrafi 3 i po këtij ligji përcakton se: ***"E drejta për marrjen e pagës së rregullt mund të pezullohet vetëm në përputhje me kushtet e përcaktuara në Ligjin për Shërbimin Civil"*** si dhe neni 5 paragrafit 2 i po këtij ligji ka përcaktuar se: ***"Paga bazë sipas këtij ligji është rezultat i angazhimit dhe përkushtimit të nëpunësit civil në pozitën e tij të punës në raport me tërsinë e pozitave të tjera të punës të përcaktuara me akt nënligjor nga Qeveria e Republikës së Kosovës"*** dhe po ashtu me Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civil janë përcaktuar në mënyrë decidive se cilat lloje të shtesave iu takojnë shërbyesve civilë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Leposaviqit, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 360/1 të datës 17.09.2018, ka arritur që të konstatoj se ankuesi Radosh Iliç realizon pagën mujore nga dy burime gjegjësisht nga Republika e Serbisë/Ministria e Punës, Punësimit dhe Çështjeve Sociale, andaj Komuna e Leposaviqit e ka pezulluar pagën e ankuesit Radosh Iliç për muajin prill të vitit 2018 pas rekomandimit të Komisionit të datës 20.02.2018 andaj Komuna e Leposaviqi ndalesën e pagës për ankuesin Radosh Iliç, e ka bërë duke pas për bazë se ankuesi në të njëjtën kohë realizon dy paga për punën e njëjte nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe aj i Serbisë andaj Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Leposaviqit ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L–149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet

- *Ankuesit Radosh Iliç;*
- *Kryetarit të Komunës së Leposaviqit;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Leposaviqit dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*

Arkivit të Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.671/2018

Eshref Shabani
Kryetar i Kolegjit

Valentina Kaçandolli Bekteshi
Procesmbajtëse

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorëzuar Primljeno/Predato Recieved/Delivery 03 . 12 . 201 8 viti god year			
Organ./Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr.Prot: Br.Prot: Prot.No:	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Količina Quantity
SKDMSH OK	7345/2018		1/4

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.br.671/2018

Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova - Veće za razmatranje žalbe u sastavu: Eshref Shabani-predsednik, Hajzer Salihu i Shkëmba Manaj-članovi i Valentina Kaçandolli- Bekteshi, viša službenica za stručnu saradnju, razmotrili su zahtev od dana 18.10.2018.godine, broj protokola 6161/2018 podnet od žalioca Radoša Ilića iz opštine Leposavić, kojim je zahtevao razmatranje žalbe broj A.br.416/2018 od dana 09.07.2018.godine, protiv organa poslodavca–opštine Leposavić, po pravnoj stvari "materijalna nadoknada", postupajući u skladu sa članom 6. stav 1 podstav 1.1 i članom 18. stav 1 podstav 1.1 Zakona br.06/L-048 o Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova, na raspravi za savetovanje i glasanje, održane dana 03.12.2018. godine, donosi:

O D L U K U

I. Odbija se kao neosnovana žalba broj A.br.671/2018 od dana 18.10.2018.godine, podneta od žalioca Radoša Ilića.

II. Ostaje na snazi Odluka br.360/1 od dana 17.09.2018.godine Komisije za rešavanje sporova i žalbi u opštini Leposavić.

O b r a z l o ž e n j e

Žalioc Radoš Ilić, zaposlen shodno Aktu o imenovanju od dana 28.02.2012.godine i od dana 01.07.2016.godine na radnom mestu-Vođa Ekipe za socijalnu pomoć u opštini Leposavić, od aprila meseca 2018.godine nije mu procesuirana plata na njegov žiro-račun za obavljeni rad, bez neke odluke institucije ili razloga. Dana 17.05.2018.godine, podneo je zahtev Direkciji za finansije, međutim nije dobio odgovor i nakon toga dana 04.06.2018.godine podneo je žalbu Komisiji za rešavanje sporova i žalbi u opštini Leposavić. Komisija za rešavanje sporova i žalbi u opštini Leposavić, uprkos zakonskoj obavezi predviđenoj zakonskim odredbama na snazi, nije razmotrila žalbu žalioca.

Protiv administrativne ćutnje opštine Leposavić, žalioc je dana 09.07.2018.godine podneo žalbu broj protokola 3833/2018 u Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova.

Veće za razmatranje žalbi, dana 03.09.2018.godine, donelo je Odluku broj A.br.416/2018, kojom je obavezao Komisiju za rešavanje sporova i žalbi u opštini Leposavić, da u roku od petnaest (15) dana od dana primanja odluke, izvrši razmatranje žalbe od dana 04.06.2018.godine podneta od žalioca Radoša Ilića.

Komisija za rešavanje sporova i žalbi u opštini Leposavić, sprovodeći odluku A.br.416/2018 od dana 03.09.2018.godine, doneta od Nezavisnog nadzornog odbora civilne službe, dana 17.09.2018.godine donela je odluku br.360/1, odlukom kojom je odbila žalbu žalioca Radoša Ilića kao neosnovanu.

Dana 18.10.2018.godine, žalioc Radoš Ilić podneo je zahtev pod brojem protokola 6161/2108 u Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova, kojim je obavestio Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova da se ne sprovodi odluka Nezavisnog nadzornog odbora civilne službe Kosova, i zahtevao od Odbora da se preduzmu mere u skladu sa zakonom, da se ovi sporovi reše u što kraćem roku. S'tim u vezi, na osnovu zahteva žalioca Radoš Ilića, Odbor je aktivirao predmet A.br.416/2018 od dana 09.07.2018.godine.

Veće za razmatranje žalbi nadležno za donošenje meritorne odluke, utvrdilo je sledeće dokaze: E-mail od dana 27.11.2018.godine; Konkurs od dana 02.06.2017.godine; Odluku od dana 03.07.2017.godine; Kandidate primljene shodno novom konkursu u julu 2017.godine; Platni spisak za isplatu ličnih dohodaka u Centru za socijalni rad od dana 14 oktobra 2017.godine; Platni spisak za isplatu ličnih dohodaka u Centru za socijalni rad od dana 14 oktobra 2018.godine; E-mail od dana 30.11.2018.godine; Dostavljanje podataka u vezi vašeg dopisa od dana 29.11.2018.godine iz opštine Leposavić, broj SI od dana 29.11.2018.godine; Platni spisak za mesec april 2018.godine iz Republike Srbije; Platni spisak za mesec avgust 2018.godine iz Republike Srbije; Platni spisak za mesec februar 2018 godine iz Republike Srbije; Platni spisak za mesec januar 2018. godine iz Republike Srbije; Platni spisak za mesec jun 2018.godine iz Republike Srbije; Platni spisak za mesec maj 2018.godine iz Republike Srbije; Platni spisak za mesec mart 2018.godine iz Republike Srbije; Platni spisak za mesec novembar 2018.godine iz Republike Srbije; Platni spisak za mesec septembar 2018.godine iz Republike Srbije; Platni spisak za mesec jul 2018.godine iz Republike Srbije; Platni spisak za mesec oktobar 2018.godine iz Republike Srbije; Zahtev žalioca Radoša Ilića od 18.10.2018.godine za Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova; Odgovor na zahtev od dana 18.10.2018.godine iz opštine Leposavić; Rešenje od dana 17.09. 2018. godine broj 360/1 Komisije za rešavanje sporova i žalbi u opštini Leposavić; Odluku broj 15/52 od 22.06.2018.godine doneta od Premijera Republike Kosova; Žalbu žalioca od 09.07.2018.godine, podneta u Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova; Ličnu kartu žalioca Radoša Ilića; Potvrdu žalioca Radoš Ilića od dana 10.02.2005.godine; Zahtev žalioca od 17.05.2018.godine podnet Direkciji za financije u opštini Leposavić; Žalbu žalioca od dana 04.06.2018.godine podneta Komisiji za rešavanje sporova i žalbi u opštini Leposavić; Sporazum o razumevanju između Ministarstva rada i socijalne zaštite i opštine Leposavić od dana 03.06.2016.godine; Spisak zaposlenih u Centru za socijalni rad od 25.05.2016.godine; Akt o imenovanju žalioca Radoš Ilića od 01.07.2016.godine, broj 01; Akt o imenovanju žalioca Radoš Ilića od 28.02.2012.godine broj 321; Ugovor o radnom odnosu žalioca Radoš Ilića od 21.04.2010. godine, broj 902; Ugovor o radnom odnosu Radoša Ilića od 29.03.2007. godine, broj 2060; Ugovor o radnom odnosu Radoša Ilića od 01.04.2002.godine; Žiro-račun žalioca Radoša Ilića; Odluku Nezavisnog nadzornog odbora civilne službe Kosova A.nr.416/2018 od 03.09.2018.godine; Zahtev za uklanjanje sa platnog spiska od 17.01.2018.godine od strane predsednika opštine Leposavić za MALS; Zahtev o davanju saglasnosti za uklanjanje sa platnog spiska od 11.06.2018.godine od predsednika opštine Leposavića; Zahtev za uklanjanje sa platnog spiska od 16.08.2018. godine od predsednika opštine Leposavića; Zahtev za uklanjanje sa platnog spiska od dana 15.08.2018. od predsednika opštine Leposavića; Odluku od dana 03.08.2018.godine, broj 710 predsednika opštine Leposavića; Izveštaj Komisije od dana

10.07.2018.godine; Tabelu zaposlenih koji su izbrisani sa platnog spiska zbog poništavanja konkursa na osnovu kojeg su primljeni u radni odnos; Rešenje o formiranju Komsiije za preispitivanje zakonitosti konkursa raspisan dana 02.06.2017.godine; Zahtev za usaglašenost procedura za raspisivanje konkursa u opštini Leposavić od dana 08.12.2016.godine od strane ministra MALS-a; Obaveštenje od dana 15.09.2015.godine, kao i zahtev za primanje radnika od dana 19.07.2017.godine.

Veće za razmatranje žalbi, nadležno za rešavanje ove upravne stvari, nakon što je razmotrilo sve predmetne spise podnete od stranaka, utvrdilo je da je žalba žalioca Radoša Ilića **neosnovana, jer:**

Žalioc Radoš Ilić, na osnovu rešenja od dana 21.09.1990.godine izdato od Centra za socijalni rad u opštini Leposavić, zasnovao je radni odnos u opštini Leposavić, dok je na osnovu sporazuma o razumevanju zaključen između Ministarstva rada i socijalne zaštite Republike Kosova i opštine Leposavić od dana 03.06.2016.godine kojim je izvršen prenos nadležnosti za socijalna pitanja na opštinski nivo, na ovoj osnovi, žalioc Radoš Ilić ima akt o imenovanju od dana 01.07.2016.godine, broj 01/2016 na radnom mestu-Vođa Ekipe za socijalnu pomoć.

Žalioc Radoš Ilić, do meseca marta 2018.godine isplaćivan je iz budžeta Republike Kosova, odnosno iz opštine Leposavić, međutim od marta meseca, žalioc je uklonjen sa platnog spiska uz obrazloženje da se isti isplaćuje i iz budžeta Republike Srbije. Na osnovu toga, Veće za razmatranje žalbi, razmotrilo je dokaze u predmetu i utvrdilo da je predsednik opštine Leposavić, dana 17.01.2018.godine podneo zahtev broj 400-76 Ministarstvu administracije lokalne samouprave o uklanjanju sa platnog spiska, nakon toga nadovezujući se na ovo, Veće je razmotrilo platni spisak dostavljen iz opštine Leposavić za žalioca Radoša Ilića koji je primao platu i nastavlja da prima platu iz budžeta Republike Srbije, odnosno podrazumeva se da je žalioc Radoš Ilić istovremeno ostvarivao dve plate iz dve različite države, što je u suprotnosti sa Zakonom br.03/L-149 o Civilnoj službi Republike Kosova, Zakonom br.03/L-147 o Platama civilnih službenika, Pravilnikom br.33/2012 o Dodacima na platu i ostalim nadoknadama civilnih službenika i Briselskim sporazumom.

Veće za razmatranje žalbi, imalo je u obzir i Odluku br.15/52 od dana 22.06.2018.godine doneta od Premijera Republike Kosova, odlukom kojom je usvojen zahtev od dana 11.06.2018.godine, broj 410/2018 podnet od predsednika opštine Leposavić o uklanjanju službenika sa platnog spiska, koji su bili na platnom spisku i koji su finansirani iz posebnog budžeta Vlade, pre potpisivanja Briselskog sporazuma iz 2013.godine, i takođe data je obaveza Ministarstvu finansija, da u saradnji sa opštinom Leposavić preduzmu radnje shodno zakonodavstvu na snazi, u vezi uklanjanja radnika koji figuriraju sa nula vrednošću na platnom spisku.

Na osnovu zakonskih odredbi člana 44. Zakona br.03/L-149 o Civilnoj službi Republike Kosova, utvrđeno je da: **"Civilni službenik za svoj posao dobija naknadu preko platnog sistema, koji će se regulisati posebnim zakonom"**, odredbama člana 5. stav 2 Zakona br.03/L-147 o Platama civilnih službenika utvrđeno je da: **"Osnovna plata prema ovom zakonu je rezultat angažovanja i privrženosti civilnog službenika na njegovoj radnoj poziciji u odnosu na celinu ostalih radnih pozicija određenih podzakonskim aktom od Vlade Republike Kosova"**, i takođe Pravilnikom br.33/2012 o Dodacima na platu i ostalim nadoknadama civilnih službenika, na decidivan način je utvrđeno koje vrste dodataka pripadaju civilnim službenicima.

Veće za razmatranje žalbi, zaključuje da Komisija za rešavanje sporova i žalbi u opštini Leposavić, prilikom donošenja odluke broj 360/1 od dana 17.09.2018.godine, uspela je da utvrdi da žalioc Radoš Ilić ostvaruje mesečnu platu iz dva izvora, odnosno iz Republike Srbije/Ministarstva za rad, zapošljavanje, i socijalna pitanja, dakle opština Leposavić obustavila je platu žaliocu Radošu Iliću za mesec april 2018. godine, nakon preporuke komisije od dana 20.02.2018 godine, dakle opština Leposavić obustavu plate za žalioca Radoša Ilića, uradila je imajući za osnovu da žalioc istovremeno ostvaruje dve plate za isti rad, iz budžeta Republike Kosova i iz budžeta Republike Srbije, dakle komisija za rešavanje sporova i žalbi u opštini Leposavić, postupila je u skladu sa Zakonom br.03/L-149 o Civilnoj službi Republike Kosova, Zakonom br.05/L-031 o Opštem upravnom postupku i Pravilnikom br.05/2011 o Procedurama rešavanja sporova i žalbi, jer je pravedno utvrdila činjenično stanje i pravnu osnovu.

Na osnovu ovih okolnosti, Veće za razmatranje žalbi, nakon analiziranja i ocene svih predmetnih spisa i zasnivajući se na nadležnost Odbora, odlučilo je kao u dispozitivu ove odluke.

Pravna pouka: Protiv odluke Odbora, nezadovoljna stranka koja tvrdi da je odluka Odbora nezakonita, može pokrenuti upravni spor u nadležni Sud, u roku od trideset (30) dana od dana kada joj je predata odluka. Pokretanje upravnog spora ne zadržava izvršenje ove odluke.

Dostaviti:

- Žaliocu Radošu Iliću;
- Predsedniku opštine Leposavić;
- Kadrovskom rukovodiocu u opštini Leposavić;
- Arhivi NNOCSK-a.

Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova
Predmet broj A.br.671/2018

Eshref Shabani	**Valentina Kaçandolli Bekteshi**
Predsednik Veća	**Zapisničarka**

Preveo:
Sh. Mujko
Dana, 03.12.2018.god